



# Periodik mujor Nr. 177 Shkurt 2024



**Në  
këtë  
periodik  
do të lexoni:**

**Misioni i Bankës Botërore takohet me  
drejtues të Autoritetit**

**Tregu i Sigurimeve, Janar 2024**

**VËSHTRIM MBI TREGJET**

**ZHVILLIME TË TJERA**

**BOTIME  
PROFESIONALE**

**5 - 9**

**INFORMACIONE  
NDËRKOMBËTARE**

**10-13**

## Misioni i Bankës Botërore takohet me drejtues të Autoritetit



Në datë 1 shkurt 2024 në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare u zhvillua takimi me ekspertë të nivelit të lartë të sektorit financiar të Bankës Botërore.

Drejtoresha Ekzekutive në detyrë Zj. Mimoza Kaçi, prezantoi përmbledhjen mbi ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrje të Autoritetit, si dhe mbi zhvillimet e fundit të kuadrit ligjor dhe rregullator. Zj. Kaçi nënvizoi angazhimin e Autoritetit në drejtim të përafritimit me Direktivën Evropiane të regjimit mbikëqyrës Solvency II. Në takim u diskutua edhe mbi rëndësinë e hartimit të një kuadri rregullator të përgjithshëm për orientimin e kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme dhe të gjelbra, si dhe vendosjen e rregullave për taksonominë.

Ekipi i Bankës Botërore duke vlerësuar potencialin që ka vendi për sigurimet në bujqësi, menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe zhvillimin e financave të gjelbra, diskutoi në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren më tej, duke evidentuar rëndësinë e bashkëpunimit institucional në këto drejtime. Autoriteti shprehu gatishmërinë për të kontribuar në këto fusha dhe për forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm me Bankën Botërore.



# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar 2024 kapën vlerën 1,774 milionë lekë, ose 3.62% më shumë se në janar 2023. Gjatë muajit janar 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 104,439 me një rritje prej 8.20% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.38% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 9.62%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.13% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.87% të totalit të tregut.

Gjatë muajit janar 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 608 milionë lekë, ose 8.50% më shumë se në muajin janar 2023.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për muajin janar 2024 kapën vlerën 413 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 17.92% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, Janar 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë muajit janar 2024 arritën në rreth 1,044 milionë lekë, ose 9.31% më shumë se në muajin janar 2023.

# ZHVILLIME TË TJERA

## Fillon zbatimi i udhërrëfyesit për regjimin e mbikëqyrjes në sigurime, Solvency II



Në datën 28 shkurt 2024, nisi trajnimi i parë në zbatim të udhërrëfyesit për regjimin mbikëqyrës në fushën e sigurimeve, njohur si Solvency II. Në këtë aktivitet tre ditor marrin pjesë rreth 40 pjesëmarrës, nga Autoriteti dhe shoqëritë e sigurimit që veprojnë në Shqipëri.

Workshopi u organizua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Bankën Botërore, në kuadër të Projektit të “Qëndrueshmërisë dhe Zhvillimit Financiar në Shqipëri”. Autoriteti është një nga përfituesit kryesorë të projektit, që mbështetet nga Programi global “Financë për Zhvillim” i Bankës Botërore dhe nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO).

Në fjalën e saj përshëndetëse, Drejtorja Ekzekutive në detyrë, Zj. Mimoza Kaçi, vlerësoi këtë aktivitet si hap të rëndësishëm në drejtim të rritjes së efektivitetit të mbikëqyrjes në tregun e sigurimeve. Ajo theksoi se përafrimi i legjislacionit tonë me standardet europiane dhe integrimi në BE janë shtyllat kryesorë të strategjisë së Autoritetit për zhvillimin afatmesëm të sektorit të sigurimeve. Zbatimi i regjimit Solvency II kërkon angazhim të përbashkët dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me kompanitë e sigurimit. Gjithashtu, Zj. Kaçi vlerësoi bashkëpunimin e suksesshëm, të Autoritetit me Bankën Botërore dhe SECO-n, për forcimin e kapaciteteve dhe për zhvillimin e një kuadri ligjor dhe mbikëqyrës modern, në përputhje me direktivat e BE, për sektorët e tregjeve të kapitalit, sigurimeve dhe pensioneve.

Vijon ...



## Fillon zbatimi i udhërrëfyesit për regjimin e mbikëqyrjes në sigurime, Solvency II




... vijon

Ky workshop shënon aktivitetin e parë, në kuadër të zbatimit të udhërrëfyesit për implementimin e regjimit Solvency II. Implementimi i regjimit të ri mbikëqyrës në sigurime, parashikohet për një periudhë 7 vjeçare me qëllim që të sigurohet një tranzicionin gradual dhe i qëndrueshëm për shoqëritë e sigurimit.

Regjimi mbikëqyrës Solvency II pritet të sjellë ndryshime të konsiderueshme në përqasjen e administrimit të rrezikut nga ana e shoqërive të sigurimit, duke mundësuar përballimin e risqeve të paparashikuara dhe zhvillimin potencial në një treg më të gjerë. Ky workshop, do të pasohet nga një seri aktivitete në vijim, të cilat do të mbështeten nga asistenca teknike e Bankës Botërore për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

## AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren bazuar në ligjin “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”



The screenshot shows the AMF website interface. At the top is the AMF logo (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare). Below it is a navigation menu with items: AMF, Legjislacioni, Stabiliteti Financiar, Mbrojtja e Konsumatorit, Edukimi Financiar, and Regjistri i të Licencuarve. A secondary menu includes Programi i Transparencës and Publikime. The main content area features a large image of a building with the title 'Projektregullore' overlaid. Below the image is a breadcrumb trail: Faqe Kryesore > Legjislacioni > Projektakte > Projektregullore. Three project regulation items are listed, each with a corresponding button: 1. 'Projektregullore "Për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe regjistrimin e fondit të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së"' with a 'VERIFIKONI POLICËN TUAJ' button. 2. 'Projektregullore "Për përcaktimin e kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat"' with a 'DEPOZITO ANKESËN ONLINE' button. 3. 'Projektregullore "Për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat"' with no button.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, ka hartuar projektregulloren: “Për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe regjistrimin e fondit të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së”

Projektregullorja e sipërpërmendur publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm:

["Për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe regjistrimin e fondit të investimeve alternative të miratuar në një vend anëtar të BE-së"](#)

## **ESMA - Kërkesat për t'u zbatuar kur postoni rekomandime për investime në mediat sociale**



Autoriteti Evropian i Letrave me Vlerë dhe Tregjet (ESMA) dhe autoritetet kombëtare po rrisin ndërgjegjësimin për kërkesat e vendosura nga rregullimet kundër abuzimit në treg (*Market Abuse Regulation, MAR*) të cilat duhet të zbatohen edhe kur postojnë rekomandime për investime në mediat sociale. Ata po paralajmërojnë edhe për rreziqet e manipulimit të tregut nga publikime të tilla.

Transparenca dhe saktësia janë thelbësore, kur postoni në mediat sociale, veçanërisht kur bëni rekomandime për investime. Kjo është arsyeja pse, nëse jeni një influencues financash, një ekspert teknik ose dikush me interes vetëm për investime financiare, duhet të jeni të vetëdijshëm për rregullat e vendosura sipas Kornizës MAR dhe të jeni në gjendje të njihni një rekomandim investimi.

### **Çfarë është një rekomandim investimi?**

Sipas MAR rekomandim investimi mund të jetë çdo postim, video ose çdo lloj tjetër komunikimi publik, duke përfshirë mediat sociale, në të cilat një person jep këshilla ose ide, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në lidhje me blerjen ose shitjen e një instrumenti financiar ose se si të hartohet një portofoli i instrumenteve financiare.

Edhe nëse një person përdor një gjuhë "jo-teknike", jep këshilla ose ide, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ai mund të përbëjë një rekomandim investimi.

Rregullat e përcaktuara gjenden në Kornizën MAR, të përbërë nga Rregullorja Nr. 596-2014 dhe Rregulloret e Delegimit dhe Zbatimit.

Vijon ...

Informacioni i plotë:

<https://www.esma.europa.eu/press-news/esma-news/requirements-when-posting-investments-recommendations-social-media>



# ESMA - Kërkesat për tu zbatuar kur postoni rekomandime për investime në mediat sociale



About ESMA | ESMA's Activities | Investor Corner | Publications & Data | Contact & Help

ESMA

Home > ESMA News > Requirements when posting investments recommendations on social media

## Requirements when posting investments recommendations on social media

INVESTOR PROTECTION | MARKET ABUSE | WARNINGS AND PUBLICATIONS FOR INVESTORS

06/02/2014

The European Securities and Markets Authority (ESMA) and National Competent Authorities are raising awareness of requirements established by the Market Abuse Regulation (MAR) which apply when posting investment recommendations on social media. They are also warning about the risks of market manipulation in such publications.

When posting on social media, transparency and accuracy are key, especially when making recommendations about investments. That is why, if you are a finance influencer, a technical expert, or someone with just interest in financial investments, you need to be aware of the rules established under the MAR Framework and be able to recognise an investment recommendation.

### What is an Investment Recommendation?

According to the MAR it can be any post, video, or any other type of public communications, including social media, in which a person gives advice or ideas, directly or indirectly, about buying or selling a financial instrument or on how to compose a portfolio of financial instruments.

Even if a person is using "non-technical" language, gives advice or ideas, directly or indirectly, about buying or selling a financial instrument or on how to compose a portfolio of financial instruments, it may constitute an investment recommendation.

... vijon

## Cilat janë kërkesat specifike?

Grupi i përgjithshëm i kërkesave thekson që çdo person që jep rekomandime investimi duhet:

- Të përfshijë identifikimin e prodhuesve të rekomandimit: emrin, titullin e punës së të gjithë personave të përfshirë dhe datën dhe orën e rekomandimit;
- Të sigurohet një paraqitje objektive e rekomandimeve për investime: faktet të jenë të dallueshme qartë nga interpretimet, vlerësimet dhe opinionet. Të konfirmohet se të gjitha burimet e informacionit janë të besueshme dhe, kur ka dyshime, të tregohen qartë cili është dyshimi;
- Të pasqyrohet qartë çdo konflikt interesi, në mënyrë që investitori ta marrë parasysh atë. Kur rekomandimet shprehen përmes kanaleve të ndryshme të mediave sociale, secili nga këto kanale të mediave sociale duhet të pasqyrojë interesat ose konfliktet e interesit.

Kërkesat shtesë kërkojnë që "profesionistët" dhe "ekspertët" të pasqyrojnë qartë:

- Përmbledhjen çdo baze të vlerësimit, metodologjisë dhe supozimeve themelore të përdorura;
- Kohëzgjatjen e investimit dhe një paralajmërim të duhur të rrezikut;
- Shpeshtësinë e planifikuar të përditësimeve që do të bëhen për rekomandimin e investimit;
- Nëse rekomandimi është ndryshuar/përditësuar pasi i është paraqitur emetuesit;
- Nëse ata kanë një pozicion neto *long* ose *short* mbi 0.5% të totalit të kapitalit aksionar të emtuar.

Informacioni i plotë:

<https://www.esma.europa.eu/press-news/esma-news/requirements-when-posting-investments-recommendations-social-media>

## BOSNJË-HERCEGOVINA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të tregut të publikuara nga Agjencia e Sigurimeve të Bosnjës dhe Hercegovinës, AZOBiH, në fund të vitit 2023, tregu i sigurimeve të Bosnjës arriti në 503.1 milionë euro (984 milionë BAM), ose rreth 11.7% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Ndërkohë shuma e përgjithshme e dëmeve të paguara nga siguruesit, u rrit me 7.7% në terma vjetorë duke arritur në 219.6 milionë euro. Dëmet e paguara për policat e sigurimit të Jetës ishin 55.5 milionë euro dhe dëmet e lidhura me kontratat e sigurimit të Jo-Jetës ishin 164 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara bruto të siguruesve që operojnë në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës u rrit me 10.9% duke arritur në 348.9 milionë euro, ndërsa siguruesit me bazë në Republikën Serbe të Bosnjës realizuan 154.2 milionë euro, ose 13.6% më shumë se një vit më parë.

Primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 13.2% krahasuar me vitin e kaluar duke arritur në 401.1 milionë euro (784.5 milionë BAM) në vitin 2023, ndërsa primet në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës u rritën me 6% krahasuar me vitin 2022 dhe arritën në 102 milionë euro (199.5 milionë BAM). Nga nënklasat e sigurimeve të Jo-Jetës, vlerat më të mëdha të primeve të shkruara bruto i korrespondojnë dy linjave të sigurimit motorik - MTPL - 245.8 milionë euro dhe sigurimi Kasko - 54.3 milionë euro, dhe sigurimi i pronës - 40.9 milionë euro.

Gjatë vitit të kaluar, në tregun e sigurimeve të Bosnjës ishin aktive 25 sigurues: 11 sigurues me bazë në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës, FBiH, dhe 14 aktorë të tregut operonin në Republikën Serbe të Bosnjës.

## KOSOVA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në fund të vitit 2023, sipas shifrave mujore zyrtare të publikuara në faqen e Bankës Qendrore të Kosovës, BQK, tregu i sigurimeve në vend u rrit me mbi 9% duke arritur në 146.50 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, totali i dëmeve të paguara bruto u rrit me 11.5% duke arritur në 71.70 milionë euro.

Sipas publikimeve të BQK-së, primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës arritën në 139.85 milionë euro, nga 127.72 milionë euro gjatë vitit 2022, ndërsa primet e sigurimit të Jetës u rritën në 6.65 milionë euro nga 6.30 milionë euro.

Numri i policave të sigurimit të Jo-Jetës u rrit me mbi 12% në vit (ose me 162.5 mijë) duke arritur në 1.48 milionë, nga të cilat 572.8 mijë - TPL motorike, 503 mijë - polica kufitare dhe 405.7 mijë ishin kontrata të tjera sigurimi jo - TPL.

Në të njëjtën periudhë, asetet në zotërim nga kompanitë e sigurimeve kosovare u rritën në 305.4 milionë euro më 31 dhjetor 2023, nga 267.5 milionë euro një vit më parë, nga të cilat siguruesit e Jetës zinin 25.5 milionë euro, ndërsa pjesa e mbetur prej 279.9 milionë euro administrohet nga siguruesit e Jo-Jetës.

## **KROACI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas publikimit nga Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare, HANFA, vëllimi i primeve të shkruara bruto i realizuar nga shoqëritë e sigurimit në vitin 2023 arriti në 1.7 miliardë euro me një rritje prej 7.1%. Pjesën më të madhe të tyre, 1.4 miliardë euro e zinin primet e sigurimit të Jo-Jetës me 81.6% të totalit, ndërsa pjesa tjetër prej 18.4% e zinin sigurimet e Jetës me vlerë 0.3 miliardë euro.

Gjatë vitit 2023 vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit me 3.8% ndërsa primet e sigurimit të Jetës u ulën me 15.0%.

Struktura e primeve të arkëtuara në sigurimin e Jo-Jetës dominohet nga sigurimi i përgjegjësishë për mjete motorike, që zë 35.5%, i ndjekur nga sigurimi i mjeteve motorike tokësore, me 18.2% dhe linjat e tjera të sigurimit të pasurisë që zënë 9.9%.

Vëllimi i dëmeve të paguara gjithashtu është rritur me 13.6% duke arritur në 1.2 miliardë euro. Dëmet e paguara në sigurimin e Jetës arritën në 419.8 milionë euro, me një rënie prej 1.5%, ndërsa për sigurimet e Jo-Jetës, dëmet e paguara arritën në 743.2 milionë euro me një rritje prej 24.3% krahasuar me vitin 2022.

Në dhjetor 2023, në tregun vendas të sigurimeve operonin 14 kompani sigurimesh.

## **MAQEDONI E VERIUT**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave paraprake të tregut për vitin 2023, të publikuara në faqen online të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në vend, shoqëritë e sigurimeve të Maqedonisë së Veriut raportuan një vëllim të primeve të shkruar bruto për vitin 2023 me vlerë 14.3 miliardë denarë ose rreth 233 milionë euro. Kjo vlerë është rreth 12.2% më shumë se një vit më parë. Ndërkohë, për vitin 2023, dëmet e paguara nga siguresit janë rritur për 13.9% duke arritur në 5.8 miliardë denarë ose rreth 95 milionë euro, nga të cilat 5 miliardë denarë janë të lidhura me sigurimet e Jo-Jetës dhe 0.8 miliardë denarë janë dëme të paguara në sigurimet e Jetës.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 12.8% krahasuar me vitin 2022 dhe arriti në vlerën e 11.8 miliardë denarë. Ndërsa primet në sigurimet e Jetës arritën në 2.5 miliardë denarë, me rritje prej 9.3% krahasuar me vitin e kaluar.



## RUMANI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për 9-mujorin 2023 në tregun e sigurimeve në Rumani arriti në vlerën rreth 13.1 miliardë RON, ose rreth 2.63 miliardë euro. Kjo vlerë është 9% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimet e Jo-Jetës zënë 83% të kësaj vlere. Duke marrë parasysh normën 8.8% të inflacionit vjetor, tregu ka mbetur i qëndrueshëm në terma realë.

Në sigurimet e Jo-Jetës, vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në rreth 10.9 miliardë RON ose 2.18 miliardë euro, duke shënuar një rritje me 8.5% në vit. Ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës arriti në rreth 2.2 miliardë RON ose 451 milionë euro, me një rritje prej 9.4% në vit.

Sipas autoritetit rumun të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dëmet e paguara bruto për sigurimin e Jetës dhe Jo-Jetës arritën në rreth 4.9 miliardë RON ose 1.14 miliardë euro. Dëmet e paguara për kontratat e sigurimit të Jo-Jetës zinin afërsisht 94% të totalit dhe arrinin në 4.6 miliardë lei ose 927 milionë euro, me rritje 6% më shumë se një vit më parë. Ndërsa dëmet e paguara në sigurimin e Jetës, arritën vlerën 266 milionë RON ose 53.5 milionë euro, me rritje rreth 10% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## TURQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, në fund të vitit 2023, sektori i sigurimeve në Turqi u rrit me 106.7% duke arritur vlerën e 486 miliardë TRY, ose 14.9 miliardë euro. E shprehur në monedhën evropiane, euro, për shkak të diferencave të kursit të këmbimit, ndryshimi i tregut ishte me rritje rreth 26.5% krahasuar me vitin 2022.

Primet e shkruara bruto në sektorin e sigurimit të Jetës u rritën me rreth 84% duke arritur në 56.7 miliardë TRY, ndërsa në sigurimet e Jo-Jetës, vëllimi i primeve të shkruara bruto pothuajse u dyfishua, me rritje mbi 110% krahasuar me vitin 2022 dhe arriti vlerën e 429.2 miliardë TRY.

Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB ka 68 anëtarët aktivë dhe volumi më i madh i primeve është gjeneruar nga siguroesi shtetëror "Turkiye Sigorta" me 12.3% pjesë të tregut.

## Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Gjatë 9-mujorit 2023, siguruesit në Evropën Qendrore dhe Lindore realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 35 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 11.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Dëmet e paguara, për të njëjtën periudhë, u rritën me 3.87%, duke arritur në 16.1 miliardë euro. Me pak përjashtime, shumica e tregjeve të këtyre vendeve patën norma dyshifrore rritjeje në tremujorin e tretë të 2023.

Sektori i sigurimeve të Jo-Jetës ka shënuar një rritje të përgjithshme rajonale prej 14.3%, duke arritur në 26.35 miliardë euro. Dëmet e paguara për sektorin e Jo-Jetës u rritën me 14.22%, duke arritur në 12.87 miliardë euro, të ndikuara kryesisht nga inflacioni.

Sigurimet motorike zënë pjesën më të madhe të sigurimeve në sektorin e Jo-Jetës: MTPL mban një peshë prej 30% të primeve të shkruara bruto në nivel të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa sigurimi Kasko zë pothuajse 22%. Për të dy këto segmente të sigurimit motorik, dëmet e paguara u rritën me rreth 15%.



Për informacion të mëtejshëm  
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)